



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Doretuar Pilmijeno/Prodato Received/Delivered	17-03-2023	viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jedintca Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHCK	2792/2023		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.100/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.100/2023 të datës 19.01.2023 të parashtruar nga ankuesja

kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “kontestimi konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 16.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.100/2023 të datës 19.01.2023, e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja me datën 19.01.2023, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 515/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.17/2023 të datës 12.01.2023, i nxjerrë nga Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë-Ministria e Punëve të Brendshme lidhur me refuzimin e ankesës për mos përfshirje në listën e ngushtë për emrin e grupit Specialist të Shkencave Shoqërore lidhur me pozitën *Inspektor i Arsimit* në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit-Inspektorati i Arsimit të Kosovës, i shpallur me datën 02.11.2022 sipas numrit të referencës RN00010341 nga Ministria e Punëve të Brendshme-Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafit 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 28.02.2023 me Vendimin me numër protokollit 2142/2023 ka vazhduar afatin për

vendimmarrje edhe për 10 ditë pune lidhur me ankesën A.nr.100/2023 të datës 19.01.2023, të parashtruar nga ankuesja

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses me Nr.Prot:515/2023 të datës 19.01.2023 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin me numër të referencës RN00010341 të datës 02.11.2022; Vendimin Nr.128/2023 të datës 06.01.2023 të Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publike-MPB për refuzimin e aplikacionit; Vendimin Nr.128/2023 të datës 06.01.2023 të Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publike-MPB për refuzimin e aplikacionit Ankesa e datës 06.01.2023 e parashtruar nga ankuesja në Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publike-MPB kundër Vendimit Nr.128/2023 të datës 06.01.2023; Vendimi Nr.17/2023 i datës 12.01.2023 i Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publike-MPB për refuzimin e ankesës së datës 06.01.2023 e parashtruar nga ankuesja; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 26.01.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 07.02.2023 nga Ministria e Punëve të Brendshme-DMZP së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Listën e aplikantëve të gjeneruar tek SIMBNJ; Njoftimin e datës 06.01.2023 lidhur me listën e ngushtë; Njoftimin e datës 24.01.2023 për listën e ngushtë nga Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në DMZP-MPB; Aplikacionin e ankueses të datës 01.12.2022 së bashku me dëshmitë mbi përvojën e punës, profesionale, dy vlerësimet e fundit, certifikatat mbi trajnimet, kopjen e letërnjoftimit si dhe certifikatën mbi evidencën penale; E-mailin zyrtar të datës 27.02.2023 me numër protokollit 2138/2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe E-mailin zyrtar të datës 03.03.2023 me numër të protokollit 2298 nga Departamenti për menaxhimin e Zyrtareve Publike-MPB; Njoftimin e datës 15.02.2023 të Ministrisë së Punëve të Brendshme-Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë për anulimin e konkursit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, konstatoi që të përfundohet procedimi administrativ i filluar me ankesën e ankueses me numër A.nr.100/2023 të datës 19.01.2023, *sepse*:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës ka gjetur se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë i Ministrisë së Punëve të Brendshme më datë 02.11.2022 ka njoftuar për shpalljen e konkursit me Nr.Reference: RN00010341 për grupin "Specialistë i Shkencave Shoqërore" lidhur me pozitën *Inspektor i Arsimit*, në kuadër të Inspektoratit të Arsimit. Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja të cilës përmes Vendimit me Nr.128/2023 të datës 06.01.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë i është refuzuar aplikacioni për shkak se e njëjta nuk ka dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara me konkurs respektivisht kopjen e dëshmisë mbi masën disiplinore. Ankuesja me datë 06.01.2023 ka parashtruar ankesë ndaj këtij vendimi, ndërsa Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë përmes Vendimit me Nr. 17/2023 të datës 12.01.2023 ka refuzuar ankesën e ankueses.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.17/2023 të datës 12.01.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtare Publikë, e njëjta kërkon që Këshilli të vazhdoj me procedura të mëtejshme të rekrutimit.

Po nga provat e lëndës, Kolegji ka gjetur së Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, përkundër ankesës se ankueses kishte vazhduar me procedurën sipas konkursit të jashtëm me numër reference RN00010341, me ç'rast përmes njoftimit të datës 15.02.2023 ka bërë anulimin e konkursit për grupin e pozitës "Specialist të Shkencave Shoqërore-Inspektor i Arsimit", kurse në përgjigje të kërkesës së Këshillit, përmes emailit të datës 03.03.2023, ka informuar Kolegjin se , citoj "Sipas kërkesës suaj, ju njoftojmë se anulimi i konkursit për grupin Specialist të Shkencave Shoqërore....., ka ndodhur për shkak të gabimeve përmbajtjesore në kriteret e konkursit, për këtë arsye është parë e nevojshme të anulohet kjo procedurë".

Kolegji i Këshillit thekson faktin së kundër Njoftimit të datës 15.02.2023 për anulim të konkursit të jashtëm me numër reference RN00010341, për grupin e pozitës "Specialist të Shkencave Shoqërore-Inspektor i Arsimit", kandidati Artan Haradinaj me datë 22.02.2023 ka parashtruar ankesë me numër A.nr.399/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli duke vendosur sipas ankesës A.Nr.399/2023 të datës 22.02.2023, ka shqyrtuar ligjshmërinë e anulimit të procedurës sipas Konkursit me numër reference RN00010341 dhe më Vendimin me numër A.nr.399/2023 të datës 15.03.2023 ka refuzuar ankesën me numër A.nr.399/2023 të datës 22.02.2023, duke lënë në fuqi Njoftimin e datës 15.02.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, pasi që në vlerësimin e Këshillit, procedura e zhvilluar sipas konkursit me numër reference RN00010341 është përfshirë me shkelje procedurale dhe materiale, kështu që anulimi i kësaj procedurë është konsideruar i bazuar dhe i ligjshëm.

Andaj, duke qenë së objekti i ankesës A.nr.100/2023 i datës 19.01.2023 ka të bëjë me procedurën e konkursit me numër reference RN00010341, për grupin e pozitës "Specialist të Shkencave Shoqërore-Inspektor i Arsimit", e cila procedurë është anuluar nga njësia përgjegjëse dhe meqenëse Këshilli me vendim meritore ka lënë në fuqi njoftimin për anulim të datës 15.02.2023, Kolegji konstaton së objekti i ankesës A.nr.100/2023 është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje, dhe si rrjedhojë në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: *Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot*, vendosi që të përfundoj procedimin administrativ i filluar sipas ankesës së ankueses

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkrësive të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe sipas nenit 104 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.



Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.100/2023.

Ardita Perçuku-Shyti

Procesmbajtëse

Malsore Gashi-Bajraktari

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

Ankueses

Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë/MPB dhe
Arkivit të KPMSHCK-së.